Ау,ЦИВСКИ ПРИМЕРОК
EGZEMPLAR ARKIVOR

Архивски знак
Shenja arkivore: 0901
Рок на чување:
Afati i ruajtjes: 1
01.04.2025 година
viti
Потпис
Nënshkrimi

Bazuar në nenin 21 paragrafi (1) pika d të Statutit të Institucionit Nacional Orkestra e Muzikës Xhaz e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe në lidhje me nenin 77-g të Ligjit të Kulturës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/1998; 49/2003; 82/2005; 24/2007; 116/2010; 47/2011; 51/2011; 136/2012; 23/2013; 187/2013; 44/2014; 61/2016 dhe 11/2018), Këshilli Drejtues i Institucionit Nacional Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së, në mbledhjen e mbajtur më 1.4.2025, miratoi:

RKESTRA E XHAZ MUZIKËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Бр.-Nr. 02-227/8
01.04. 2025 год.-viti
СКОПЈЕ - SHKUP

Rregullore

për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ofruesve të shërbimeve publike në kulturë

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra dhe procedura për zbatimin e vlerësimit të ofruesve të shërbimeve publike në Institucionin Nacional Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së nga kategoria B – bashkëpunëtorë artistikë për përgatitjen e veprave në fushën skenike dhe muzikore-skenike dhe kategoria G – bashkëpunëtorë profesionalë në veprimtaritë e kulturës.

Vlerësimi i efektit të të punësuarve nga kategoria A – artistë, me përjashtim, do të rregullohet me akt të veçantë të institucionit (Rregullore për riaudicion).

Neni 2

Vlerësimi kryhet me qëllim që të merret një pasqyrë reale për profesionalizmin, cilësinë dhe efikasitetin e të punësuarve në kryerjen e detyrave të punës.

Rezultatet e vlerësimit, përkatësisht vlerësimi për efektin, profesionalizmin dhe kompetencën e të punësuarve, merren në konsideratë edhe në procedurat për sistemimin dhe avancimin e të punësuarve.

Eprori i drejtpërdrejtë është i detyruar ta ndjekë vazhdimisht efektin e të punësuarit nga niveli menjëherë më i ulët gjatë gjithë vitit dhe, sipas nevojës, të propozojë masa për përmirësim.

Neni 4

(1) Vlerësimi i efektit të ofruesve të shërbimit publik në kulturë, me përjashtim të kategorisë A niveli A1, kryhet një herë në vit dhe jo më vonë se më 1 dhjetor për vitin aktual.

(2) Vlerësimin nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen eprori i drejtpërdrejtë i ofruesit të shërbimit publik në kulturë, përkatësisht drejtori, në rastet kur nuk ka epror të drejtpërdrejtë (në tekstin vijues: vlerësuesi).

Neni 5

(1) Të dhënat e marra gjatë vlerësimit, regjistrohen në Formularin për vlerësimin e ofruesit të shërbimit publik, i cili është dhënë në shtojcën e kësaj rregulloreje.

1

(2) Formulari për vlerësim ruhet në dosjen e punës së të punësuarit, i cili merr një kopje të formularit.

(3) Kundër procedurës së vlerësimit, i punësuari i pakënaqur ka të drejtë brenda afatit prej tetë ditësh të paraqesë ankesë për vlerësimin te Këshilli drejtues i institucionit.

Neni 11

(1) I punësuari i cili gjatë vitit për të cilin kryhet vlerësimi ka qenë i munguar nga puna më shumë se gjashtë muaj (sëmundje, mungesë e papaguar dhe të tjera – shënohen në formular), si dhe i punësuari që është punësuar për herë të parë dhe ka punuar më pak se gjashtë muaj në periudhën për të cilën kryhet vlerësimi, nuk do të vlerësohet.

(2) Vlerësimin e të punësuarit, i cili gjatë vitit për të cilin kryhet vlerësimi është sistemuar, përkatësisht marrë në një vend tjetër pune, e kryen vlerësuesi i ri, mbi bazën e vlerësuesit të mëparshëm.

(3) Nëse vlerësuesi, gjatë vitit për të cilin kryhet vlerësimi, e ndryshon vendin e punës ose i ndërpritet marrëdhënia e punës, vlerësimin e të punësuarve e kryen drejtuesi i ri mbi bazën e raportit me shkrim nga i mëparshmi.

Neni 12

(1) Pas përfundimit të vlerësimit, formularët dorëzohen te njësia organizative për burime njerëzore, e cila përgatit raport për rezultatet e vlerësimit dhe ia dorëzon drejtorit jo më vonë se më 31 janar të vitit vijues.

2) Formulari për raportin nga paragrafi (1) i këtij neni përmban: vulë me numër arkivor dhe datë, të dhëna për numrin e të vlerësuarve dhe të pavlerësuarve, arsyet e mosvlerësimit, paraqitje tabelore të vlerësimeve të kryera dhe nënshkrimin e personit drejtues të institucionit.

(3) Formulari është në shtojcën e kësaj rregulloreje.

Neni 13

Këtë Rregullore e miraton Këshilli drejtues i IN Orkestra e Muzikës Xhaz e RMV-së dhe hyn në fuqi me ditën e miratimit të saj.

Neni 14

Rregullorja do të publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqe ата на установата.



Претседател на УО,

Сашко Николовски